



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor, 2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 17.05.2021, merr këtë

V E N D I M
PËR SUBVENCIONIMIN E KLUBEVE TË BASKETBOLLIT, HENDBOLLIT DHE
VOLEJBOLLIT

I.

MIRATOHET Vendimi për subvencionimin e klubeve të basketbollit, hendbollit dhe volejbollit në Prishtinë.

II.

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 100,000.00 €. Për klubin e basketbollit 50,000.00 €, klubin e hendbollit 30,000.00 € dhe klubin e volejbollit 20,000.00 €, shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, programi i Administratës së përgjithshme.

III.

Qëllimi i këtij vendimi është dhënia e ndihmës, të cilën Komuna e Prishtinës ua ndan klubeve të basketbollit, hendbollit dhe volejbollit në Prishtinë, për shkak të situatës pandemike të krijuar nga virusi COVID -19 dhe masave restriktive nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-451/01-87874/21, më 19.05.2021

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Guleta

